



Pranuar / Dorezuar / Primjen / Prudatu / Received / Delivety	16-11-2023	viti god year	3
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	6998/2023		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1369/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1369/2023, të datës 02.11.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.11.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1369/2023, të datës 02.11.2023, të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi (këtu e tutje vetëm ankuesi), me datë 02.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr.03/2023 të datës 21.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me pretendimet ankimore se i njëjti me rastin e aplikimit për pozitën *Inspektor shëndetësor*, të shpallur sipas konkursit të datës 11.07.2023, ka bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara, duke përfshirë shkollimin, përvojën e punës si dhe dëshminë lidhur me masën disiplinore të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë si punëdhënës i fundit.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 6833/202, të datës 02.11.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatën e ankuesit nga implatechone, ë muajt prill 2023; Certifikatën e ankuesit nga Oda Stomatologjike e Maqedonisë 2021-2022; Certifikatën e ankuesit nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Profesionistëve Dentar, e periudhës

15-16 nëntor 2019; Certifikatën e ankuesit, të datës 11.10.2017, Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj; Certifikatën e ankuesit nga Shoqata e Stomatologëve të Republikës së Kosovës, për periudhën 27-29 tetor 2017; Certifikatën e ankuesit për periudhën 09-11 maj 2019, nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Profesionistëve Dentar; Certifikatën e ankuesit të datës 01.05.2018, nga Oda e Stomatologëve të Kosovës; Certifikatën e ankuesit për periudhën 27-29 tetor 2017, nga Shoqata e Stomatologëve të Republikës së Kosovës; Certifikatën e ankuesit nga Stomatologjia e avancuar dhe QKSUK, për periudhën 28-29 Prill 2018; Certifikatën e ankuesit nga Fdi World Dental Federation, për periudhën 09-11 maj 2019; Certifikatën e ankuesit nga Këshilli Studentor i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, për periudhën 12-14 maj 2022; Certifikatën e ankuesit të datës 29.06.2022, nga Oda Stomatologjike e Maqedonisë; Licencën e punës së ankuesit të datës 09.08.2022, nga Oda e Stomatologëve të Kosovës; Njoftimin e datës 28.05.2019, nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Licencën e punës të datës 08.08.2017, nga Ministria e Shëndetësisë; Vendimin me numër 07Nr.966/2017, të datës 21.12.2017, nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Hanin e Elezit; Vendimin me Nr.2952, të datës 09.06.2023, nga Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës; Vendimin me Nr.95/15, të datës 04.09.2015, nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës; Diplomën e ankuesit me Nr.960, të datës 22.02.2005, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Mjekësisë; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 28.07.2023; Rekomandimin e datës 01.07.2001, nga The Forum; Vendimin me numër 02Nr.011/2010 të datës 19.01.2010, nga Kryetari i Hanit të Elezit; Certifikatën e ankuesit nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, për periudhën 06 dhe 07 nëntor 2019; Diplomën e ankuesit me numër protokoll 321, të datës 02.06.1994, për kryerjen e shkollës së mesme; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 07.08.2023, nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Akt emërimit e ankuesit me Nr.189 të datës 08.07.2019; Kontratën e datës 01.09.2014 mbi zbatimin e shkollimit specialistik; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Ankesën e ankuesit e parashtruar tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr.17/2023 të datës 29.08.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr.03/2023 të datës 21.08.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe Vendimin me numër A.nr.1138/2023 të datës 01.11.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi që përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1369/2023 të datës 02.11.2023, e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 04.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr. 1138/2023 kundër Vendimit me Nr.03/2023 të datës 21.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me refuzimin e aplikacionit dhe mos përfshirjen në listën e ngushtë, në procedurën e pranimit sipas Konkursit me nume të referencës RN00012041, për emrin e grupit "Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë - Inspektor Shëndetësor"

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 04.09.2023, me Vendimin me numër A.nr.1138/2023 të datës 01.11.2023, ka

refuzuar ankesën e ankuesit të datës 04.09.2023, duke lënë në fuqi Vendimin me Nr.17/2023 të datës 29.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Ankuesi, sërish me datë 02.11.2023, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke atakuar Vendimin Nr.03/2023, të datës 21.08.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit sipas Konkursit me numër të referencës RN0001204, për emrin e grupit "Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë -Inspektor Shëndetësor" dhe me pretendimin se i njëjti me rastin e aplikimit ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas konkursit, duke përfshirë shkollimin, përvojën e punës si dhe dëshminë lidhur me masën disiplinore.

Andaj, Kolegji bazuar në gjendjen e fakteve si me sipër, ka gjetur se objekti i ankesës A.nr. 1369/2023 të datës 02.11.2023, është i njëjtë me objektin e ankesës A.nr.1138/2023 të datës 04.09.2023, të parashtruar nga ankuesi, përkatësisht ankuesi me të dyja ankesat ka kundërshtuar Vendimin Nr.03/2023, të datës 21.08.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe mbi bazën e pretendimeve të njëjta ankimore. Kështu që, nisur nga fakti, se Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore përmes Vendimit A.nr.1138/2022 të datës 01.11.2023, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 101, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktik..," konstaton se janë plotësuar kërkesat ligjore për përfundim të procedurës administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1369/2023 të datës 02.11.2023 të parashtruar nga ankuesi


Theksuar si me lart, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1369/2023

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së

